**Enkelejda Alite**
**Auditues Ligjor**
**Adresa: Rr.Abdi Toptani,Torre Drin, Kati 0, Zyra 19, Tirane**
**Mob. +355 (0)67 2005022**
**E-mail:enkealite@yahoo.com**

---

# RAPORT I AUDITIMIT TE FONDEVE TE PERFITUARA DHE TE SHPENZUARA GJATE FUSHATES ZGJEDHORE PER ZGJEDHJET E DATES 25.04.2021 TE KANDIDATIT TE PAVARUR z.ILJAZ SHEHU

## A. INFORMACIONI LIGJOR

### i. Kuadri Ligjor

- Ligji nr.10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar;
- Ligji nr. 8580, datë 17.02.2000 "Për Partitë Politike", i ndyshuar;
- Ligji 10091, datë 05.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe kontabilistit të miratuar";
- Ligji nr.25/2018, "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare";
- Udhezimi nr.13, datë 06.04.2021, të Komisionit Rregullator, "Për përcaktimin e rregullave për raportimin financiar të subjekteve zgjedhore, kontrollin dhe verifikimin e financimeve dhe shpenzimeve të tyre gjatë fushatës zgjedhore".
- Udhezimi nr.14, datë 09.06.2021, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, "Për caktimin e kritereve, procedurat për përzgjedhjen dhe emërimin e ekspertëve kontabël të liçensuar (auditEuesve ligjor) dhe kushtet kontraktuale për auditimin e fondeve të përfituara dhe të shpenzuara nga partitë politike gjatë vitit kalendarik dhe subjektet zgjedhore dhe kandidatët e tyre në fushatën zgjedhore".

### ii. Standartet e zbatueshme

- Standartet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-te).
- Standartet Kombëtare të Kontabilitetit (SKK 10) për OJF-të.

**Enkelejda Alite**
**Auditues Ligjor**
**Adresa: Rr.Abdi Toptani,Torre Drin, Kati 0, Zyra 19, Tirane**
**Mob. +355 (0)67 2005022**
**E-mail:enkealite@yahoo.com**

## B. OBJEKTI I AUDITIMIT

### i. Kontrata e shërbimit

Raporti i auditimit të fondeve të përfituara dhe të shpenzuara gjatë fushatës zgjedhore për zgjedhjet e datës 25.04.2021, të Z.Iljaz Shehu kandidat për deputet i propozuar nga zgjedhësit në zonën zgjedhore qarku Lezhë, për zgjedhjet për Kuvend të datës 25 Prill 2021 , u hartua mbi bazën e kontratës së shërbimit të nënshkruar me Komisionin Qëndror të Zgjedhjeve nr. Prot. 6488 datë 20.09.2021. Objekti i kësaj kontrate është kryerja e auditimit ligjor të detyrueshëm të fondeve të përfituara dhe të shpenzuara gjatë fushatës zgjedhore për zgjedhjet 2021, nga subjektet zgjedhore në përputhje me Kodin Zgjedhor,i ndryshuar, Ligjin nr.8580, të datës 17.02.2000 "Për Partitë politike", i ndryshuar, Ligjin nr. 10091, të datës 05.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe kontabilistit të miratuar" dhe Ligjin nr. 25/2018 "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare".

### ii. Vendimi i KQZ-së

Gjithashtu, raporti për auditimin e fondeve të përfituara dhe të shpenzuara gjatë fushatës zgjedhore për zgjedhjet 2021, të datës 25.04.2021, te Z.Iljaz Shehu u hartua mbi bazën e vendimit nr.426 të datës 12.07.2021 "Për shpalljen e rezultatit të shortit për emërimin e ekspertëve kontabël të liçensuar (auditues ligjor), të cilët do të kryejnë auditimin e fondeve të përfituara dhe të shpenzuara nga subjektet zgjedhore për fushatën zgjedhore, për zgjedhjet për Kuvendin e Shqiperisë të datës 25.04.2021" .

## iii. Përgjegjesitë respektive të palëve, Z.Iljaz Shehu, kandidat për deputet në zgjedhjet e datës 25.04.2021 dhe Enkelejda Alite, Auditues Ligjor

### a. Përgjegjësia e Drejtimit dhe e Personave të Ngarkuar me Qeverisjen

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të deklaratave financiare që japin një pamje të vërtetë dhe të drejtë në përputhje me Ligjin nr. 25/2018 "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare", Standartet Kombëtare të Kontabilitetit (SKK-te) dhe për kontrollin e brendshëm, i cili në masën që përcaktohet nga Drejtimi, është i nevojshëm për të bërë të mundur përgatitjen e deklaratave financiare pa anomali materiale, si pasojë e mashtrimeve apo gabimeve.

Referuar nenit 92/6, pika 2 dhe 3 e Kodit Zgjedhor thuhet se:

- Subjektet zgjedhore duhet të vënë në dispozicion të auditit të emeruar nga KQZ-ja cdo informacion, dokument apo të dhënë, që ka të bëjë me financimin dhe shpenzimet e fushatës zgjedhore.
- Subjektet zgjedhore që auditohen duhet të vënë në dispozicion cdo informacion që disponojnë nga bankat, institucione apo persona të tretë që kanë lidhje me auditimin.

### b. Përgjegjësia e Audituesit Ligjor

Përgjegjësia jonë është të shprehim një opinion mbi këto deklarata financiare bazuar mbi auditimin tonë. Ne kryem auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit. Këto standarde kërkojnë që ne të respektojmë kërkesat etike, të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin me qëllim që të përfitojmë siguri të arsyeshme që deklaratat financiare nuk kanë pasaktësi materiale. Auditimi përfshin kryerjen e proçedurave

**Enkelejda Alite**
**Auditues Ligjor**
**Adresa: Rr.Abdi Toptani,Torre Drin, Kati 0, Zyra 19, Tirane**
**Mob. +355 (0)67 2005022**
**E-mail:enkealite@yahoo.com**

për të marrë evidencë auditimi për shumat dhe informacionet e paraqitura në deklaratat financiare. Proçedurat e përzgjedhura varen nga gjykimi i auditusit, përfshirë dhe vlerësimin e rrezikut për pasaktësi materiale në deklaratat financiare, si rezultat i mashtrimit apo gabimeve. Në bërjen e këtyre vlerësimeve mbi rrezikun, audituesi konsideron kontrollin e brendshëm, si proçedura auditimi të përshtatshme sipas rrethanave, por jo për qëllimin e shprehjes së një opinioni mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të subjektit zgjedhor. Një auditim përfshin gjithashtu vlerësimin dhe përshtatshmërinë e parimeve kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve kryesore të bëra nga drejtimi, si dhe vlerësimin e paraqitjes së përgjithshme të deklaratave financiare. Ne besojmë se evidencat e auditimit që kemi marrë, ofrojnë baza të arsyeshme për dhënien e opinionit tonë të auditimit.

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse deklaratat për raportimet financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve, do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston. Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, indiviualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë në vendimet e përdoruesve të marra bazuar në këto deklarime dhe raporte financiare.

Audituesi Ligjor duhet të hartojë Raportin e Auditimit në përputhje me ligjin nr.10091, datë 05.03.2009, “Për Auditimin Ligjor, Organizimin e Profesionit të Ekspertit Kontabël të Regjistruar dhe Kontabilistit të Miratuar”, ligjin nr.8580, datë 17.02.2000, “Për Partitë Politike”, ndryshuar dhe ligjin nr.25/2018 “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare” si dhe aktet nënligjore të nxjerra në bazë dhe për zbatim të tyre.

Audituesi Ligjor
do të auditojë në mënyrë specifike:

- Raportet Finaciare (formatin tip) të zgjedhjeve sipas modelit të KQZ-së, të ardhurat dhe shpenzimet e subjektit zgjedhor te pavarur për fushatën zgjedhore;
- Hapjen e llogarive të posacme bankare nga subjekti zgjedhor për fushatën në momentin e regjistrimit sipas nenit 64 të Kodit Zgjedhor dhe derdhjen e të gjitha dhurimeve me vlerë më të madhe se 50.000 leke në kete llogari të posacme sipas nenit 92/2, pika 2 e Kodit Zgjedhor;

- Transaksionet financiare të kryera për periudhën 6 muaj para fushatës dhe gjatë fushates zgjedhore, si dhe në cdo moment tjetër që kanë lidhje me fushatën nga persona fizikë ose juridikë, me qëllim evidentimin e transaksioneve të pajustifikuara që mund të jenë përdorur për financim të paligjshëm të fushatës zgjedhore;
- Donacionet, huatë apo kreditë që i jepen subjektit zgjedhor për fushatën zgjedhore mund të behen vetëm nga persona fizike ose juridike vendas sipas nenit 92/1, pika 1 e Kodit Zgjedhor;
- Regjistrimi në një regjistër të posaçëm miratuar si model me vendim të KQZ-së të fondeve të përfituara nga cdo person fizik ose juridik si dhe të dhëna të tjera që lidhen me identifikimin e qartë të dhuruesit sipas nenit 92/2, pika 1 e Kodit Zgjedhor;
- Respektimi i kufirit maksimal të marrjes së një donacioni, kredie apo huaje e cila nuk mund të jetë më e madhe se 1 milion leke sipas nenit 92/1, pika 2 e Kodit Zgjedhor;
- Zbatimin e cdo dispozite ndaluese për financimin e fushatave të përcaktuara në Kodin Zgjedhor dhe në ligjin nr. 8580, datë 17.02.2000, “Për Partitë Politike”, i ndryshur;
- Dokumentimin e shpenzimeve të subjekteve të treta në funksion të veprimtarive të fushatës së subjektit zgjedhor dhe perputhjen e tyre me legjislacionin tatimor;
- Vleresimi i dhurimeve në natyrë;
- Respektimin e kufirit maksimal të shpenzimeve të fushatës zgjedhore sipas nenit 92/2, pika 4 e Kodit Zgjedhor ku thuhet se shuma e shpenzimeve të bëra nga një subjekt zgjedhor në një fushatë zgjedhore nuk duhet të jetë më shumë se 3 herë më e madhe se shuma me e lartë që ka marrë një subjekt zgjedhor nga fondet publike për qëllime zgjedhore ;
- Gjetjet e evidentuara gjatë procesit të monitorimit dhe çështjeve të shqyrtuara në funksion të raportit të auditimit.
- Të dhënat e raporteve financiare të subjektit zgjedhor do të krahasohen me gjetjet dhe përfundimet ne raportin e auditimit ;
- Në përfundim do të paraqesim një raport për KQZ-në.

## C.PREZANTIMI I SUBJEKTIT ZGJEDHOR TEK AUDITUESI LIGJOR

### i. Prezantimi i subjektit zgjedhor

Z.Iljaz Shehu është anëtar i lëvizjes VetVendosje në Shqipëri krijuar nga lëvizja VetVendosje me qëndër në Kosovë dhe e drejtuar nga Z.Albin Kurti. Kjo lëvizje synon që të shkojë në Kuvendin e Shqipërisë nëpërmjet kandidateve të saj propozuar për zgjedhjet e datës 25.04.2021. Një ndër këta kandidatë i propozuar për qarkun e Lezhës është edhe Z.Iljaz Shehu.

Lëvizja VetVendosje, Dega Tiranë, garon për herë të parë në zgjedhjet parlamentare për Kuvendin e Shqipërisë.

Z.Iljaz Shehu është i regjistruar nga KQZ me vendimin nr.143, datë 16.03.2021 si kandidat për deputet i propozuar nga zgjedhësit në zonën e qarkut Lezhë.

Burimet financiare të kandidatit janë:

- Dhurimet në mjete monetare dhe në natyrë;
- Çdo e ardhur tjetër që nuk bie në kundërshtim me legjislacionin për financimin e partive politike.

## *D. PARAQITJA E RAPORTIT DHE STRUKTURA E TIJ*

### i. Struktura e raportit të auditimit – kërkesat formale, të ardhurat dhe shpenzimet

Të ardhurat e fushatës zgjedhore për zgjedhjet 2021, të datës 25.04.2021 janë **342,150 lekë**. Këto të ardhura janë krijuar:

- Të ardhurat(dhurimet) nga persona fizike ne mjete monetare 210,150 lekë
- Të ardhurat(dhurimet ne natyre)nga persona fizike 132,000 lekë

# I. KËRKESAT FORMALE

## A. PËRMBLEDHJE

| | | | |
|---|---|---|---|
| **1/ Data e dorëzimit** | | | |
| | a) dorëzim në formë elektronike | Po | 12.10.2021 |
| | b) dorëzim fizik | Po | 12.10.2021 |
| **2/ Nënshkrimi** | | | |
| | Nënshkrimi | Po | 12.10.2021 |
| **3/ Llogaria bankare e veçantë / Personi përgjegjës i financës** | | | |
| | a) evidenca e hapjes së llogarisë bankare | Po | 01.03.2021 |
| | b) Dokumenti i lëvizjeve në llogarinë bankare (bank statement) që mbulon periudhën e fushatës | Po | 01.03.2021-01.07.2021 |
| | c) identiteti i personit përgjegjës të financës | Po | Iljaz Shehu |

a. Llogaria bankare e veçantë

Llogaria bankare e vecantë është hapur nga kandidati Z.Iljaz Shehu për fushatën zgjedhore dhe është përdorur për qëllime të fushatës zgjedhore 2021, të datës 25.04.2021.
Është hapur një llogari në Leke pranë Union Bank me IBAN:AL76214541050540556496010117.
Hapja e llogarisë për fushatën zgjedhore është bërë më qëllim për të marrë të gjitha donacionet mbi 50,000 lekë, por edhe donacionet nën 50.000 leke kur transferimi bëhet nëpërmjet llogarisë bankare. Gjithashtu aty evidentohen të gjitha shpenzimet e paguara me transfertë bankare që lidhen me aktivitetin e fushatës zgjedhore.

Subjekti Zgjedhor nuk ka llogari bankare " të fjetura" që janë përdorur për zgjedhjet e mëparshme.

Raporti i financimit të fushatës se kandidatit Z.Iljaz Shehu i raportuar pranë KQZ-së , nuk ka defiçit, totali i të ardhurave është i barabartë me totalin e shpenzimeve.

Llogaria bankare për fushatën zgjedhore, në Union Bank , është çelur sipas evidencës të marrë nga banka më datë 03.09.2021
Ne kemi siguruar bank statement që ka të bëjë me transaksionet financiare në funksion të fushatës zgjedhore, e cila përfshin periudhën nga data 01.03.2021-01.07.2021

**b/ Personi përgjegjës për Financën**

Nuk ka person përgjegjës për financat e kandidatit Z.Iljaz Shehu.
Nenshkrimi i raportit të financimit të fushates zgjedhore është bërë nga Z.Iljaz Shehu.

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | a) bosh/mungon informacioni | Jo | | |

**Enkelejda Alite**
**Auditues Ligjor**
**Adresa: Rr.Abdi Toptani,Torre Drin, Kati 0, Zyra 19, Tirane**
**Mob. +355 (0)67 2005022**
**E-mail:enkealite@yahoo.com**

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | b) dokumentacioni (shqyrtim i shpejtë) | | | |
| | | ***Të Ardhurat*** | | 342,150 |
| | | | Financime publike | |
| | | | Donacione private | 342,150 |
| | | | Financim nga burimet e veta të partisë | |
| | | | Huatë/Kreditë | |
| | | ***Shpenzimet*** | | 342,150 |
| | | | Mitingje/tubime dhe aktivitete ne fushatë | 149,750 |
| | | | Materialet promocionale | 59,422 |
| | | | Media | |
| | | | Media Sociale | |
| | | | Sondazhe | |
| | | | Botime | |
| | | | Shpenzime zyra elektorale | |
| | | | Transporti | |
| | | | Konsulenca | |
| | | | Reklamime në natyre | 132,000 |
| | | | Administrative dhe të përgjithshme | 978 |

# II. TË ARDHURAT

## *A.* PËRMBLEDHJE

| | | Sipas raportit të financimit të fushatës zgjedhore | Sipas auditimit të kryer |
|---|---|---|---|
| **1/ Financimi publik** | | | |
| | Shuma e pagesës paradhënie | | |
| | Data e tranfertës | | |
| | Shuma e pagesës së marrë pas zgjedhjeve | | |
| | Data e transfertës | | |
| | Shuma e financimit publik e kthyer, nëse ka | | |
| | Data e transfertës | | |
| **2/ Donacionet private** | | | |
| | Shuma e përgjithshme e raportuar | 342,150 | 342,150 |
| | Shuma e donacioneve në para | 210,150 | 210,150 |
| | Shuma e donacioneve në natyrë | 132,000 | 132,000 |
| | Përgatitet një listë e donatorëve | | |
| | Përfshihen të gjitha dokumentet e lëvizjeve në llogaritë bankare (bank statement) | | |
| | Përputhshmëria midis çdo donacioni të raportuar dhe dokumentit të lëvizjeve në llogaritë bakare (bank statement) (shuma) | | |
| | Përputhshmëria midis çdo donacioni të raportuar dhe dokumentit të lëvizjeve në llogaritë bakare (bank statement) (data) | | |
| | Përputhshmëria midis çdo donacioni të raportuar dhe dokuementit të lëvizjeve në llogaritë bankare (bank statement) (donatori) | | |

| | | | |
|---|---|---|---|
| | Përputhshmëria mes çdo donacioni në natyrë të raportuar dhe vlerës së tregut (donatori / data) | | |
| | A përputhen shifrat në total (të përgjithshme)? | | |
| | Respektimi i kufirit të donacionit | | |
| **3/ Financimi nga burimet e vetë partisë** | | | |
| | Shuma e përgjithshme e raportuar | | |
| | Shuma e përgjithshme e raportuar (Zyra Qendrore) | | |
| | *Kuotat e anëtarësisë* | | |
| | *Botimet* | | |
| | *Shtypshkronja* | | |
| | *Marrje me qera* | | |
| | Transferte nga llogaria e partise | | |
| | Shuma e përgjithshme e raportuar (degët lokale) | | |
| | *Kuotat e anëtarësisë* | | |
| | *Botimet* | | |
| | *Shtypshkronja* | | |
| | *Marrje me qera* | | |
| | Përputhshmëria mes çdo të ardhure të raportuar dhe dokumentit të lëvizjeve në llogaritë bankare (bank statement)(shuma) | | |
| | Përputhshmëria mes çdo të ardhure të raportuar dhe dokumentit të lëvizjeve në llogaritë bankare (bank statement) (data) | | |
| **4/ Huatë/Kreditë** | | | |
| | Shuma e përgjithshme e raportuar | | |
| | Shuma / shuma e huasë / kredisë (për çdo kredi / hua) | | |
| | Data e huasë / kredisë dhe data e shlyerjes (për çdo kredi / hua) | | |

**Enkelejda Alite**
**Auditues Ligjor**
**Adresa: Rr.Abdi Toptani,Torre Drin, Kati 0, Zyra 19, Tirane**
**Mob. +355 (0)67 2005022**
**E-mail:enkealite@yahoo.com**

| | | | |
|---|---|---|---|
| | Paraqitja e dokumenteve mbështetëse (kontratat për secilën kredi / hua) | | |
| **5/ Marrja/Arkëtimi i të ardhurave** | | | |
| Të gjithë të ardhurat në para të marra / të mbledhura përmes llogarisë specifike. | | Po | |

### *B.* ANALIZA

a. Financimi publik

Nuk ka financime publike.

b. Financimi nga burimet jo publike

Kontrolli i identitetit të donatorëve dhe lejueshmëria e çdo donacioni të deklaruar.

Gjatë procesit të auditimit ne nuk mundëm të sigurojmë evidencë në lidhje me donatorët, për këtë arsye nuk arritëm të verifikojmë identitetin e donatorëve dhe plotësimin e deklaratës mbi konfliktin e interesit për financimin e kandidatëve sipas vendimit nr.13, datë 06.04.2021 të Komisionit Rregullator.

Për sa i përket kufirit të shumës së lejuar për donacione sipas Kodit Zgjedhor ai është zbatuar. Kjo është lehtësisht e verifikueshme nga bank statement pranë Union Bank, e cila është llogaria e vecantë bankare e hapur për fushatën zgjedhore të kandidatit të pavarur Z.Iljaz Shehu.

Financime nga burimet jo publike të palejuara, nuk ka. Nga inspektimi i dokumentacionit financiar dhe transaksioneve financiare, **nuk u identifikuan transaksione të pajustifikuara që mund të jenë përdorur për financim të paligjshëm të fushatës zgjedhore.**

**Kontributet ne natyre**

Kandidati ka kontribute në natyrë në vlerën 132.000 leke, të cilat përbëhen nga shpenzime për karburant për fushatën zgjedhore në vlerën 32.000 leke dhe shpenzime për printimin e programit elektoral në vlerën 100.000 leke.

c. Financimi nga burimet e vetë partisë politike

Nuk ka financime nga kandidati pavarur.

**d/ Huatë/Kreditë**

- Nuk jane marrë hua për financimin e shpenzimeve të fushatës zgjedhore.

## *III.* SHPENZIMET

### *A.* PËRMBLEDHJE

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Shuma e përgjithshme e raportuar | | | 342,150 | | | | |
| Respektimi i kufirit të shpenzimit | | | Po | | | | |
| **Shpenzimet e kryera nga Zyra Qendrore e partisë** | | | | | | | |
| | **Shpenzimet zgjedhore të deklaruara në raportin e financimit të fushatës zgjedhore** | Faturat e paraqitura | Faturat e Përgjithshme | Dokumente mbështetëse që mungojnë | Shpenzime të papaguara | Mospërputhje në lidhje me dokumentet e paraqitura nga furnitorët | **Shuma e përgjithshme e shpenzimeve zgjedhore sipas auditimit** |
| Mitingje/tubime dhe aktivitete ne fushatë | 149,750 | Po | Po | Nuk ka | Nuk ka | Nuk ka | 149,750 |
| Materiale promocionale | 59,422 | Po | Po | Nuk ka | Nuk ka | Nuk ka | 59,422 |

Enkelejda Alite
Auditues Ligjor
Adresa: Rr.Abdi Toptani,Torre Drin, Kati 0, Zyra 19, Tirane
Mob. +355 (0)67 2005022
E-mail:enkealite@yahoo.com

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Media | | | | | | | |
| Media sociale | | | | | | | |
| Sondazhe | | | | | | | |
| Botime/Publikime | | | | | | | |
| Transporti | | | | | | | |
| Konsulenca | | | | | | | |
| Reklamime ne natyre | 132,000 | Deftese Kontribut ne natyre | Nuk ka | Nuk ka | Nuk ka | Nuk ka | 132,000 |
| Shpenzime zyre elektorale | | | | | | | |
| Administrative dhe të përgjithshme | 978 | Bank statement | Nuk ka | Nuk ka | Nuk ka | Nuk ka | 978 |
| **Shpenzimet e bëra nga degët e partisë** | | | | | | | |
| | **Shpenzimet zgjedhore të deklaruara në raportin e financimit te fushatës zgjedhore** | Faturat e paraqitura | Faturat e Përgjithshme | Dokumente mbështetëse që mungojnë | Shpenzime të papaguara | Mospërputhje në lidhje me dokumentet e paraqitura nga furnitorët | **Shuma e përgjithshme e shpenzimeve zgjedhore sipas auditimit** |
| Mitingje/tubime dhe aktivitete ne fushatës | | | | | | | |
| Materiale promocionale | | | | | | | |

**Enkelejda Alite**
**Auditues Ligjor**
**Adresa: Rr.Abdi Toptani,Torre Drin, Kati 0, Zyra 19, Tirane**
**Mob. +355 (0)67 2005022**
**E-mail:enkealite@yahoo.com**

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Media | | | | | | | |
| Media sociale | | | | | | | |
| Sondazhe | | | | | | | |
| Botime/Publikime | | | | | | | |
| Transporti | | | | | | | |
| Konsulenca | | | | | | | |
| Reklamime ne natyre | | | | | | | |
| Shpenzime zyre elektorlae | | | | | | | |
| Administrative dhe të përgjithshme | | | | | | | |
| **Shpenzimet zgjedhore** | | | | | | | |
| Të gjitha shpenzimet zgjedhore të bëra janë paguar përmes një llogarie të veçantë | | | | | | | Po |

B.ANALIZA

**a.Respektimi i kufirit të shpenzimeve te fushates (eshte cdo shpenzim qe ben nje parti ose kandidatet e saj per qellime te fushates zgjedhore):**

Për partitë politike 167.480.250 leke ndërsa për kandidatët e pavarur 27.913.375 leke.

Eshte respektuar kufiri i shpenzimeve të fushatës për kandidatët e pavarur në përputhje me nenin 92/2, pika 5 e Kodit Zgjedhor.

**PËRFUNDIMI**

***A.*** **SINTEZA**

- Përmbledhja e gjetjeve dhe përfundimeve

Gjatë procesit të auditimit të fondeve të përfituara dhe të shpenzuara nga kandidati i pavarur Z.Iljaz Shehu u konstatuan këto gjetje që ndikojnë në dhënien e opinionit tonë.

- Ne nuk mundëm të sigurojmë evidence në lidhje me identifikimin e donatorëve dhe deklaratat e tyre mbi konfliktin e interesit për financimin e kandidatit sipas vendimit nr.13, date 06.04.2021 te Komisionit Rregullator.

## *B.* PËRFUNDIMI

Çertifikimi me përmirësime/rezerva/opinioni me rezervë

### Opinioni me rezervë

Ne kemi audituar deklaratat financiare të fushatës për zgjedhjet për Kuvend të datës 25.04.2021 të kandidatit të pavarur Z.Iljaz Shehu, të cilat përfshijnë fondet e përfituara dhe të shpenzuara gjatë kësaj fushate.

Sipas opinionit tonë, me përjashtim të efekteve të çështjeve të përshkruara në seksionin e Bazës për Opinionin me Rezervë të raportit tonë, pasqyrat financiare bashkëlidhur paraqesin drejtë, në të gjitha aspektet materiale, fondet e përfituara dhe të shpenzuara gjatë fushatës zgjedhore 2021 të kandidatit të pavarur Z,Iljaz Shehu në përputhje me Kodin Zgjedhor, ligjin nr.8580, date 17.02.2000"Për Partitë Politike" i ndryshuar dhe ligjin nr.9228, date 29.04.2004 "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare".

### Baza për opinionin me rezervë

Pa dashur të ndryshojmë opinionin tonë, ne dëshirojmë të tërheqim vëmendjen për çështjet e mëposhtme për kandidatin e pavarur Z.Iljaz Shehu:

- Sipas nenit 92/2, pika 1 e Kodit Zgjedhor subjekti zgjedhor dhe kandidatët e pavarur duhet të regjistrojnë në një regjistër të posaçëm, miratuar si model me vendim të KQZ-së, shumën e fondeve të përfituara nga cdo person fizik ose juridik si dhe të dhëna të tjera që lidhen me identifikimin e qartë të dhuruesit. Në çastin e dhurimit dhuruesi nënshkruan një deklaratë ku zotohet se ai nuk ndodhet në një nga

Enkelejda Alite
Auditues Ligjor
Adresa: Rr.Abdi Toptani,Torre Drin, Kati 0, Zyra 19, Tirane
Mob. +355 (0)67 2005022
E-mail:enkealite@yahoo.com

rrethanat e përcaktuara në nenin 92/1 e këtij ligji dhe mban përgjegjësi personale për deklarim të rreme. Forma dhe përmbajtja e deklaratës miratohet nga KQZ-ja dhe është e detyrueshme për tu nënshkruar në cdo rast dhurimi.
Gjatë procesit të auditimit ne nuk morëm evidence në lidhje me identifikimin e donatorëve dhe plotësimin e deklaratës mbi konfliktin e interesit për financimin e kandidatëve.

Ne e kryem auditimin në përputhje me Standartet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standarteve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit të Përgjegjësive të Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare. Ne jemi të pavarur nga subjekti zgjedhor në përputhje me kërkesat etike që janë të përshtatshme për auditimin e pasqyrave financiare dhe kemi përmbushur edhe përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë me rezervë.

**ENKELEJDA ALITE**
**AUDITUES LIGJOR**

ENKELEJDA ALITE
AUDITUES LIGJOR
NUIS:L01606037A

**Tirane, date 12.10.2021**

**Enkelejda Alite**
**Auditues Ligjor**
**Adresa: Rr.Abdi Toptani,Torre Drin, Kati 0, Zyra 19, Tirane**
**Mob. +355 (0)67 2005022**
**E-mail:enkealite@yahoo.com**

**Shenime. Bashkengjitur do të gjeni:**

- ✓ Lista e donatorëve
- ✓ Pasqyrat e Raportimeve Financiare (Formati tip i raportuar nga kandidati pavarur Z.Iljaz Shehu dorëzuar ne KQZ.

**Tabela e fondeve të përfituara nga kandidati i pavarur Z.Iljaz Shehu prej personave juridikë ose fizikë vendas për zgjedhjet e datës 25.04.2021 për Kuvendin e Shqipërisë**

| | Pershkrimi I dhurimit | Vlera ne Leke | Identiteti I plote I dhuruesit | NIPTI/Karta identitetit | Data e dhurimit | Numri I llogarise ku u depozitua dhurimi prane Union Bank |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Transferte bankare | 117,000 | Sami Sulstarova | I20214159P | 12.04.2021 | 540556496010117 |
| 2 | Dhurim ne natyre | 100,000 | Emiliano Cela | I51223091A | 03.04.2021 | |

# Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ)

**Formati tip i raportimit financiar të fushatës zgjedhore për "Kandidatin e paraqitur nga një grup zgjedhësish" për zgjedhjet për Kuvend**

Model i miratuar me vendim nr. 13 datë 06.04.2021 të Komisionit Rregullator

Periudha e raportimit: *gjashtë muaj para fillimit të fushatës zgjedhore dhe periudha e fushatës zgjedhore*

*Në bazë të Kodit Zgjedhor (neni 92/3), të gjitha subjektet zgjedhore duhet të raportojnë për donacionet dhe shpenzimet e kryera për qëllime të fushatës zgjedhore, dhe duhet të mbajnë dhe dorëzojnë edhe dokumentacionin mbështetës. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka miratuar këtë format të standardizuar për raportim, i cili detajon të gjithë informacionin që duhet të dorëzohet nga subjektet zgjedhore. Ky format tip i standardizuar do të dorëzohet si në versionin elektronik me anë të emailit në adresën e shënuar më poshtë, ashtu edhe i printuar, pranë Drejtorisë së Kontrollit Financiar dhe Auditit të Brendshëm të KQZ-së.*

**Ky format raportimi konsiston në seksionet e mëposhtme:**

1. Informacion për subjektin zgjedhor, përmbledhje financiare dhe deklarata
2.a Të ardhura monetare - Financime jopublike
2.b Të ardhura, dhurime në natyrë - Financime jopublike
3. Huatë dhe Kreditë
4.a Shpenzimet
4.b Shpenzimet për mitingjet e fushatës (pasqyrë)

Ju lutemi, sigurohuni që të keni plotësuar të gjitha tabelat e këtij formati tip të raportimit para se ta dorëzoni. Tabela **"Referenca"** nuk ka nevojë të plotësohet.

Ky raport i plotësuar duhet të dorëzohet dorazi tek Drejtoria e Kontrollit Financiar dhe Auditit të Brendshëm në KQZ dhe gjithashtu me email në adresën: Valbona.Ballgjini@kqz.gov.al

Iljaz Shehu

## 1. Informacion për subjektin zgjedhor, përmbledhje financiare dhe deklarata

### Pjesa A - Informacion për subjektin zgjedhor

| | |
|---|---|
| Emri i plotë i subjektit i zgjedhor: | ILJAZ SHEHU |
| Adresa e selisë së subjektit zgjedhor | LEZHE |
| Emri/Mbiemri i personit përgjegjës për financat (nëse është i ndryshëm nga kandidati) | ILJAZ SHEHU |
| Adresa e emailit e personit përgjegjës për financat | ilishehu@hotmail.com |
| Numri i telefonit të personit përgjegjës për financat | 689034983 |

### Pjesa B - Përmbledhje financiare

| | | |
|---|---|---|
| Totali i të ardhurave: | ALL | 342,150.00 |
| b. Totali i të ardhurave nga persona fizike | ALL | 342,150.00 |
| c. Totali i të ardhurave nga persona juridike | ALL | - |
| Totali i huave: | ALL | - |
| Totali i shpenzimeve: | ALL | 342,150.00 |
| a. Totali i shpenzimeve | ALL | 210,150.00 |
| b. Totali i shpenzimeve indirekte | ALL | 132,000.00 |
| c. Totale të papaguara/detyrime financiare | ALL | - |

### Pjesa C - Deklarata

**Duke qenë i/e vetëdijshëm për pasojat ligjore në rast të deklaratave të paplota, të pasakta ose të rreme, në bazë të njohurive të mia më të mira dhe me përgjegjësi për përgatitjen e këtij raporti, unë konfirmoj vërtetësinë e të dhënave të paraqitura në këtë dokument.**

| | |
|---|---|
| Firma e personit përgjegjës për financat /përgatitur nga: (nëse ka) | ILJAZ SHEHU |
| Data e firmosjes: | 10/09/2021 |
| Aprovuar/Miratuar nga: | ILJAZ SHEHU |
| Data e firmosjes: | 10/09/2021 |

Iljaz Shehu

## 3. Huatë dhe Kreditë

Ju lutemi konfirmoni nese nuk keni gjë per te raportuar 3. Huate dhe Kreditë [ ]

| | |
|---|---|
| Firma e personit përgjegjes/ përgatitur nga: (nëse ka) | |
| Data e firmosjes. | |
| Aprovuar/Miratuar nga. | |
| Data e firmosjes. | |

| A. Emri i Huadhënësit | B. Statusi i huadhënësit | C. Adresa e huadhënësit (rreshti 1) | D. Adresa e huadhënësit (rreshti 2) | E. Kodi postar i huadhënësit | F. Numri i identifikimit i huadhënësit | G. Numri i referencës se huasë/kredise | H. Shuma e huasë/limiti i kredisë | I. Data e fillimit të huasë/kredisë | Termat<br>J. Norma e interesit | Termat<br>K. Data e shlyerjes | Termat<br>L. Kolaterali i ofruar |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|

Iljaz Shehu

## 4.a Shpenzimet

Ju lutemi konfirmoni nëse nuk keni gjë për të raportuar 4 a Shpenzimet

| | |
|---|---|
| Firma e personit pergjegjës/ pergatitur nga: (nëse ka) | |
| Data e firmosjes: | |
| Aprovuar/Miratuar nga: | |
| Data e firmosjes: | |

| | | | | | | | | | | Shpenzimet e zyres elektorale | Mitingjet e fushatës | | | Media | | Materiale promocionale/Media Sociale/Sondazhe/Publikime dhe reklama/Transport/Reklamime në natyrë/Konsulencë |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| A. Kategoria e shpenzimeve | B. Shitesi/furnizuesi | C. Nr identifikimit të faturës | D. Data e faturës | E. Data e pagesës | F. Shuma e paguar | | G. Shuma e papaguar (nëse ka) | | H. Metoda e kryerjes së pagesës | I. Shpjegimi | j. Sipas qarkut | K. Vendi i mitingut | L. Ambienti | M. Data e mitingut | N. Lloji i medias | O. Pershkrimi | P. Pershkrimi |
| Materiale promocior | Mandia Print | 96419068 | 14/04/2021 | 26/04/2021 | ALL | 59 422.00 | ALL | - | Transfertë bankare | Adeziv te printuara ba | Tiranë | | | | | | |
| Shpenzime zyre elek | Ylli Zefi | 15643909 | 20/04/2021 | 20/04/2021 | ALL | 51,300.00 | ALL | - | Para në dorë/cash | Dreke me grupin vullne | Lezhë | | | | | | |
| Shpenzime zyre elek | Ylli Zefi | 15643910 | 20/04/2021 | 20/04/2021 | ALL | 98,450.00 | ALL | - | Para në dorë/cash | Dreke me grupin vullne | Lezhë | | | | | | |
| Shpenzimet administ | Komisione bankare | | | | ALL | 978.00 | | | Transfertë bankare | Komisione bankare | | | | | | | |

Iljar Shehu

### 4.b Shpenzimet për mitingjet e fushatës (pasqyrë)

| | |
|---|---|
| Firma e personit përgjegjës/ përgatitur nga (nese ka) | |
| Data e firmosjes. | |
| Aprovuar/Miratuar nga | |
| Data e firmosjes | |

Ju lutemi konfirmoni nëse nuk keni gjë për të raportuar 4 b Shpenzimet për mitingjet e fushates (pasqyrë)

A. Mitingjet e fushates | B. Kategoritë e shpenzimeve për mitingje | C. Kostoja

Iljaz Shehu

| Lloji_i_zgjedhjeve |
|---|
| Parlamentare |
| Lokale |

| Lloji_dhurimit |
|---|
| Dhurime monetare |
| Dhurime në natyrë |
| Te ardhura te krijuara nga subjekti |

| Statusi_i_dhuruesit |
|---|
| Person fizik |
| Person juridik |
| Entitet juridik |

| Metoda_e_dhurimit |
|---|
| Para në dorë/cash |
| Çek bankar |
| Transfertë bankare |
| Kartë krediti/debiti |

| Lloji_i_shpenzimit |
|---|
| Mitingje/tubime dhe aktivitete n |
| Materiale promocionale |
| Media |
| Media sociale |
| Sondazhe |
| Botime/Publikime |
| Transporti |
| Konsulenca |
| Reklamime në natyrë |
| Shpenzime zyre elektorale |
| Shpenzimet administrative |

| Lloji_i_medias |
|---|
| TV |
| Radio |
| Printime |
| Online |

| Po_Jo |
|---|
| Po |
| Jo |

Iljaz Shehu

| Data me e hershme | Marrë_nga | Aktiviteti_qe_ka_krijuar_te_ardhura | Të_pa_raportueshme | Kategoria_e_shpenzimit | Kategoria_shpenzimeve_te_fushates | [illegible] | Kryer_nga | Qarku |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 01/01/2017 | Zyra qendrore | Shtypi i printuar | Të dhënat e mëposhtme | Zërat e shpenzimeve monet | Shpenzime për vendin/ambjentin | | Zyra qendrore | Berat |
| | Dega | Shitja e publikimeve | Konfirmoj se nuk kemi zëra për të raportuar | Shpenzime të papaguara | Shpenzime për zbavitje/argëtim | | Dega | Dibër |
| | | Dhënia me qera | | | Shpenzime për pajisje | | | Durres |
| | | Interesa bankare | | Detyrime financiare | Shpenzime për pije | | | Elbasan |
| | | Kuotat e anetaresisë | | | Shpenzime për reklama/promocion | | | Fier |
| | | Transfertë nga llogaritë e partisë | | | Shpenzime për transport | | | Gjirokaster |
| | | Të tjera (specifikoni në kolonën e fundit) | | | Shpenzime administrative | | | Korçe |
| | | | | | | | | Kukes |
| | | | | | | | | Lezhe |
| | | | | | | | | Shkoder |
| | | | | | | | | Tirane |
| | | | | | | | | Vlore |

Iljaz Shehu